

NIPT: L02401014C, Rr. "Vangjel Noti" Nr 25, Laprakë, Tiranë. Tel. 04 2 454 893. Mob: 067 40 08 880; 0674008881: 067 40 63 042.

Web: [www.apb.edu.al](http://www.apb.edu.al). Email: [info@apb.edu.al](mailto:info@apb.edu.al).

Nr. 422 Prot, datë 30.01.2015

Nr. 139 Prot, datë 03.02.2015

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

**AKADEMISË PROFESIONALE TË BIZNESIT, TIRANË**

DHE

**KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

ndërmjet

1. **AKADEMIA PROFESIONALE E BIZNESIT**, me seli në adresën: Rruga " Vangjel NOTI" Nr.25, Laprakë, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Z/Zj. **Ylber Bezo**, që vepron në kuadrin e kësaj marrëveshje.

**Dhe**

2. **KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**, me seli në rrugën Sami Frashëri, Nr.10, katër II-të, Tiranë, me përfaqësues **zpj. Irma Baraku**, Komisionere.

*Neni 1*

Kjo marrëveshje synon realizimin e bashkëpunimit nëpërmjet dy institucioneve tona. Ky bashkëpunim mund të konkretizohet në të gjitha fushat dhe disiplinat me interes të përbashkët.

*Neni 2*

Institucionet, pale të kësaj marrëveshje konfirmojnë nevojën e përpjekjeve në drejtim të konsolidimit të vlerave kulturore, shkencore dhe akademike në vend, e cila ndikon pozitivisht në drejtim të forcimit të klimës së shtetit të së drejtës dhe impenjohen:

1. Të punojnë së bashku në këto aspekte:
  - Praktika mësimore për studentët, për tu njobur me bazën ligjore, raste konkrete në lidhje me problemet që lidhen me diskriminimin
  - Aktivitete të ndryshme që lidhen me ndërgjegjësimin për problemet e diskriminimit
  - Leksione të hapura që lidhen me barazinë gjinore dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

### *Neni 3*

Për realizimin e objektivave të kësaj marrëveshje, palët mund të nënshkruajnë marrëveshje specifike në përputhje me legjislacionin përkatës për të disiplinuar të gjitha aspektet lidhur me inisiativat e veçanta.

Çdo protokoll veprimi duhet të aprovohet dhe nënshkruhet nga organet kompetente respektive.

Kjo marrëveshje nuk sjell asnje detyrim për palët për të realizuar kushtet e protokolleve të veprimit.

### *Neni 4*

Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh duke filluar nga data e nënshkrimit nga ana e përfaqësuesve ligjorë të palëve nënshkruese.

Kjo periudhë fillon nga data më e fundit e vendosur në marrëveshje.

Kjo marrëveshje mund të zgjatet ose rinovalohet, pas marrëveshjes së shprehur nga palët, nëpërmjet aprovimit nga ana e organeve kompetente respektive.

### *Neni 5*

Inisiativa për të hequr dorë nga kjo marrëveshje mund të avancohet nga secila palë në çdo moment kohor nëpërmjet një paralajmërimi me shkrim të paktën 4 (katër) muaj para.

Aktivitetet korente nuk preken nga një tërheqje e tillë, por ato do të disiplinohen nga protokollet e veprimit respektivë.

### *Neni 6*

Përsa i përket gjërave që shprehimisht nuk janë parashikuar nga kjo marrëveshje u referohet marrëveshjeve ekzekutive të veçanta.

### *Neni 7*

Çdo parashikim i kësaj marrëveshje mund të ndryshohet apo të revokohet në çdo kohë, pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet dy institucioneve.

### *Neni 8*

Kjo marrëveshje hyn në fuqi menjëherë, pas nënshkrimit nga përfaqësuesit e institucioneve përkatëse.

Kjo marrëveshje hartohet në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga 2 kopje për secilën palë dhe nënshkruhet si më poshtë.

**Akademie Profesionale e Biznesit**



**Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi**

